VENDIM
Nr.285, datë 17.5.2006

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME, SHTETËRORE, NË BASHKINË E LUSHNJËS, TË QARKUT FIER

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, shtetërore, që janë në juridiksionin, territorial dhe administrativ, të bashkisë së Lushnjës, të qarkut Fier, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj bashkie.

Lista me 270 (dyqind e shtatëdhjetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 4 270 (katër mijë e dyqind e shtatëdhjetë).

2. Ndryshimet, që mund t'i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha